

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 3 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10<sup>1</sup> të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 41 paragrafi (6) nga Ligji i njëjtë, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 3 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 të Rregullores për punë të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, për të marrë vendim lidhur me Njoftimin për ndryshim të strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë PA1 nr.02-197 datë 22.5.2023, në pajtim me Konkluzionin e Këshillit ark.nr.02-2231/4 datë 30.5.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 16-të mbajtur më 29.5.2023 miratoi si vijon:

## VENDIM

1. LEJOHET ndryshim në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, përkatësisht:

- për përfaqësimin e personit fizik Janko Micev, me NVAQ dhe adresë në Strumicë, me pjesëmarrje prej 100% në kapitalin bazë dhe

- për përfaqësimin e personit fizik Shoqëria për ndërtimtari, prodhimtari, tregti dhe shërbime SINERXHI GRUP INZHENERING SHPK Strumicë, me NVAQ 7563493 dhe seli në rr.„Manush Turnovski“ nr.15, Strumicë, ku pronarë janë: personi fizik Vasko Jordanov, me NVAQ, adresë në, me pjesëmarrje prej 50% në kapitalin bazë dhe personi fizik Nikolla Milushev, me pjesëmarrje prej 50% në kapitalin bazë.

2. Detyrohet Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, pas ndryshimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij Vendimi, drejtuar Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele t'i dorëzojë statusin aktual të dhënë (lëshuar) nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

## Arsyetim

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, në pajtim me nenin 41 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshim të strukturës së pronësisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.171/14), me Njoftim për ndryshim të strukturës së pronësisë PA1 nr.02-197 datë 22.5.2023., e njoftoi Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) për qëllimin e tij për zbatimin e ndryshimit në strukturën e pronësisë të shoqërisë.

Është konstatuar se njoftimi i dorëzuar për ndryshim të strukturës së pronësisë PA1 nr.02-197 datë 22.5.2023., nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, është i plotë dhe i rregullt, përkatësisht i përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin përkatës të përcaktuar në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshim të strukturës së pronësisë.

Agjencia, për të shqyrtuar nëse ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë do të mund të krijojnë përqendrim të kundërligjshëm mediatik, gjegjësisht nëse bien në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) dhe 38 nga LSHMAAV, nëpërmjet Sistemit të shpërndarjes së internetit të Regjistrimit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV), ofroi (siguroi) „Informacion për subjektet e ndërlidhura (persona të autorizuar, organet drejtuese, pronarët në subjekte të tjera) – gjendjen vijuese“, nr.0820-50/150020230134392 datë 23.5.2023. për Shoqërinë (Ndërmarrje) për ndërtimtari, prodhimtari, tregti dhe shërbime SINERXHI GRUP INXHENERING SHPK Strumicë; „Informacion për subjektet e ndërlidhura (personat e autorizuar, organet drejtuese, pronarë të subjekteve të tjera) – gjendjen vijuese“, nr.0820-50/150020230134410 datë 23.05.2023. për personin fizik Vasko Jordanov dhe „Informacion për subjektet e ndërlidhura (personat e autorizuar, organet drejtuese, pronarë në subjekte të tjera) – gjendjen vijuese“, nr.0820-50/150020230134413 datë 23.05.2023. për personin fizik Nikolla Millushev, nga ku shihet:

Shoqëria për ndërtimtari, prodhimtari, tregti dhe shërbime SINERXHI GRUP INXHENERING SHPK Strumicë, me veprimtari prioritare/shifra kryesore e të ardhurave është 41.20 – Ndërtimi objekteve banesore

<sup>1</sup>Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).

dhe jo-banesore, figuron si: partener (bashkëpronar) në Shoqërinë për prodhimtari, tregti dhe shërbime SOLAR GRU ENERXHI SHPK eksport-import f.Gradoshorci, Vasilevo, me veprimtari prioritare/shifra kryesore e të ardhurave 35.11 – Prodhues të rrymës elektrike (ky person juridik nuk figuron si themelues i shoqërive tregtare) dhe pronar i Shoqërisë për prodhimtari, tregti dhe shërbime EKO SOLLAR ENERXHI SHPK eksport-import Strumicë, me veprimtari prioritare/shifra kryesore e të ardhurave 35.11 – Prodhim të energjisë elektrike (ky person juridik nuk figuron si themelues i shoqërive tregtare).

Personi fizik Vasko Jordanov paraqitet si: partner në Shoqërinë për peshkim, blegtori, prodhimtari, tregti dhe transport RIBNIK BEZGASHTEVO GORICA SHPK eksport-import f. Rusinovo, Berovë, me veprimtari prioritare/shifra kryesore e të ardhurave 03.22 – Akuakulturë e ujërave të ëmbla (ky person fizik nuk figuron si themelues i shoqërive tregtare); pronar i: 1) Shoqërisë për prodhimtari, tregti dhe shërbime GUDIS FUDS SHPKNJP Strumicë, me veprimtari prioritare/shifra kryesore e të ardhurave 47.24 – Tregti me pakicë e bukës, brumëra, ëmbëlsira dhe biskota në dyqane (markete) të specializuara (ky person fizik nuk figuron si themelues i shoqërive tregtare); 2) Shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime MOBI SELL DMM SHPK eksport-import Strumicë, me veprimtari prioritare/shifra kryesore e të ardhurave 47.42 – Tregti me pakicë të pajisje për telekomunikim në dyqane të specializuara (Ky person fizik nuk paraqitet si themelues i shoqërive tregtare); 3) Shoqëria për qarkullim dhe shërbime AVTO SHKOLLA SITI STAR SHPK Strumicë, me veprimtari prioritare/shifra kryesore e të ardhurave 85.59 – Arsimit tjetër nuk përmendet diku tjetër (ky person fizik nuk figuron si themelues i shoqërive tregtare) dhe 4) Shoqëria për ndërtimtari, prodhimtari, tregti dhe shërbime ELIT BILLDING SHPK Strumicë, me veprimtari prioritare/shifra kryesore e të ardhurave 41.20 – Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo-banesore (ky person fizik nuk figuron si themelues i shoqërive tregtare); person i autorizuar filiali, pronar dhe drejtues të Shoqërisë për qarkullim dhe shërbime BAMIKO BET SHPKNJP Strumicë, me veprimtari prioritare shifra kryesore e të ardhurave 92.00 – Veprimtari lojëra të fatit dhe baste; pronar dhe administrator të: 1) Shoqërisë për prodhimtari, tregti dhe shërbime BAMIKO GRUP SHPK eksport-import Strumicë, me veprimtari prioritare/shifra kryesore e të ardhurave 35.11 – Prodhim të rrymës elektrike (ky person fizik nuk figuron si themelues i shoqërive tregtare) dhe 2) Shoqëria (ndërmarrja) për ndërtimtari, prodhimtari, tregti dhe shërbime SINERXHI GRUP INXHENERING SHPK Strumicë (të dhënat për personin fizik janë treguar mësipër); administrator të Shoqërisë për prodhimtari, tregti dhe shërbime SOLAR GRUP ENERXHI SHPK eksport-import f.Gradshorci, Vasilevo (të dhënat për personin fizik janë treguar mësipër).

Personi fizik Nikolla Millushev pretendon të jetë pronar i: 1) Ndërmarrjes (Shoqërisë) për ndërtimtari, prodhimtari, tregti dhe shërbime SINERXHI GRUP INXHENERING SHPK Strumicë; 2) Shoqëri për qarkullim dhe shërbime AVTO SHKOLLA SITI START SHPK Strumicë; dhe 3) Shoqëri për ndërtimtari, prodhimtari, tregti dhe shërbime ELIT BILLDING SHPK Strumicë (të dhëna për personat fizik janë treguar mësipër).

Gjithashtu, Agjencia ka kryer inspektim dhe në Regjistrin e pronarëve të vërtetë, i cili udhëhiqet nga Regjistri Qendror i RMV-së, nga ku është siguruar dokument: „Gjendja aktuale për personin fizik – pronar i vërtetë“, nr.2007-50/150020230134472 datë 23.5.2023., ku shihet qartë se personi fizik Vasko Jordanov paraqitet si pronar i vetëm (vërtetë) të subjekteve juridike në vijim: Shoqërisë për peshkim, bujtari, prodhimtari, tregti dhe transport RIBNIK BEZGASHTEVO GORICA SHPK eksport-import f. Rusinovo, Berovë; Shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime GUDIS FUDS SHPKNJP Strumicë; Shoqëri për prodhimtari, tregti dhe shërbime MOBI SEL DMM SHPK eksport-import Strumicë; Shoqëri për qarkullim dhe shërbime BAMIKO BET SHPKNJP Strumicë; Shoqëri për prodhimtari, tregti dhe shërbime BAMIKO GRUP SHPK eksport-import Strumicë; Shoqëri për ndërtimtari, prodhimtari, tregti dhe shërbime SINERXHI GRUP INXHENERING SHPK Strumicë dhe Shoqëri për qarkullim dhe shërbim AVTO SHKOLLA SITI START SHPK Strumicë.

Gjithashtu, Agjencia siguroi dokument: „gjendja vijuese e personit fizik – pronar i vërtetë (vetëm)“, nr.2007-50/150020230134494 datë 23.5.2023., nga ku shihet qartë se personi fizik Nikolla Millushev paraqitet si pronar i vërtetë në subjektet juridike në vijim: Shoqëri për ndërtimtari, prodhimtari, tregti dhe shërbime SINERXHI GRUP INXHENERING SHPK Strumicë dhe Shoqëri për qarkullim dhe shërbime AVTO SHKOLLA SITI STAR SHPK Strumicë.

Pra, pas ndryshimit të strukturës së pronësisë, pronar i vetëm i Shoqërisë Tregtare Radiodifuziv TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë do të jetë personi juridik Shoqëria për ndërtimtari, prodhimtari, tregti dhe shërbime SINERXHI GRUP INXHENERING SHPK Strumicë, me NVAQ dhe seli në, pronarë të të cilëve janë: personi fizik Vasko Jordanov, me NVAQ, adresë në rr. „Manush Turnovski“ nr.15, Strumicë, me pjesëmarrje prej 50% në kapitalin bazë (kryesor) dhe personi fizik Nikolla Millushev, me NVAQ adresë në rr.„Vasil Surçev“ nr.56, Strumicë me pjesëmarrje prej 50% në kapitalin bazë.

Duke pasur parasysh se Agjencia ka konstatuar se me zbatimin e ndryshimit të strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë nuk paraqitet konceptim i paligjshëm mediatiek në aspekt të LSHMAAV, gjegjësisht se ky ndryshim nuk bie ndesh me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 nga Ligji i njëjtë, pas dorëzimit të Njoftimit për ndryshim të strukturës së pronësisë PA1. Nr.02-197 datë 22.5.2023, Këshilli i Agjencisë, miratoi Vendim si në dispozitiv.

**Nr.02-197**

**30.05.2023**  
**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike**  
**Audio dhe Audiovizuale,**  
**Kryetar i Këshillit**  
**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij Vendimi transmetuesi, nëse është në kundërshtim me vendimin ka të drejtë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit të paraqesë padi për ngritjen e kontestit administrativ para gjykatës kompetente.